



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

**Njoftim për Shtyp**

**Për përqëndrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 80% të aksioneve të Bankës Amerikane të Shqipërisë tek Intesa SanPaolo S.p.a**

Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e tij të datës 09.05.2007, shqyrtoi çështjen me objekt: Njoftimi për përqëndrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 80% të aksioneve nga BAA tek Intesa San Paolo S.p.a.

Transaksioni i njoftuar konsiston në shitblerjen e 80% të aksioneve të pjesës së kapitalit në BAA nga Intesa San Paolo S.p.a të barabarta me 12 milionë aksione të BAA-së. Në përfundim të këtij transaksioni, Intesa San Paolo S.p.a do të zotërojë 80% të aksioneve të BAA-së dhe AAEF do të zotërojë 20% të aksioneve mbetëse të kapitalit aksionar të BAA-së.

**Vlerësimi i impaktit në konkurrencë**

Transaksioni konsiston në përfitim të drejtpërdrejtë të pronësisë së pjesës të BAA-së në tregun bankar, nëpërmjet procedurës së shitblerjes së aksioneve.

Nga analiza post-përqëndrimit, vërehet se tregu është i hapur për konkurrencë, pa barriera hyrëse dhe karakterizohet nga prania e konkurrentëve të fortë, me pjesë tregu të konsiderueshme dhe konkretisht në tregun e depozitave, bonove të thesarit, kredive etj. Përqëndrimi sjell ndryshime në strukturën e tregut bankar, duke e forcuar dhe rritur pozicionin e Intesa San Paolo S.p.a jo vetëm në tregun kombëtar, por edhe në atë ndërkombëtar.

Pavarësisht nga sa më sipër, ky përqëndrim i parë në këndvështrimin e efikasitetit të tregut, rrit konkurrueshmërinë në tregun bankar, zgjerimin e tregut të produktit dhe tregut gjeografik duke nxitur futjen e shërbimeve/produkteve të reja dhe numrin e degëve dhe agjencive në nivel kombëtar, rritjen e standardeve të bankingut për shkak të eksperiencës që ka Intesa San Paolo S.p.a në tregun ndërkombëtar, etj.

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës vendosi të autorizojë, përqëndrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së 80% të aksioneve të Bankës Amerikane të Shqipërisë nga kompania Intesa San Paolo S.p.a, Itali.